

Vendim nr. 132 datë 20.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 20.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ELMAZ AHMETAJ

OBJEKTI: Kundërshtimi i vendimit nr. 81, datë 19.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë “Për mospranimin e kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Elmaz Ahmetaj në datën 17.03.2023 ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) ankimin kushtetues individual, me objekt shfuqizimin e shprehjes “*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 96/2016), si të papajtueshme me Kushtetutën.

2. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 81, datë 19.04.2023 (vendimi nr. 81/2023), ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk ka justifikuar interesin e tij vetjak, real dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, pasi ka paraqitur pretendime me natyrë përgjithësuese dhe nuk ka dhënë ndonjë argument për të provuar pasojat negative të ardhura ose të pritshme për të drejtat ose liritë kushtetuese të tij nga zbatimi i normës ligjore të kundërshtuar. Në këto kushte, ai nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi nuk ka justifikuar interesin e tij, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

3. Pas dhënies së vendimit nr. 81/2023, kërkuesi në datën 25.05.2023 i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për kundërshtimin e këtij vendimi, duke përsëritur në fund të parashtrimeve kërkimin për shfuqizimin e shprehjes “*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016 (dispozita ligjore e kundërshtuar).

II

Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se argumentet e paraqitura në kërkesën e datës 17.03.2023 kanë qenë të mjaftueshme, në mbështetje të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe ka shtuar se dispozita ligjore e kundërshtuar është përdorur nga gjyqtarët dhe prokurorët në proceset gjyqësore të tij, duke i cenuar të drejtat themelore. Sipas tij, kërkesa për shfuqizimin e dispozitës ligjore është e të gjithë individëve që kanë probleme me drejtësinë dhe gjyqësorin në Shqipëri.

III

Vlerësimi i Kolegjit

5. Kolegji konstaton se objekti i kërkesës është formuluar për kundërshtimin e vendimit nr. 81/2023 të Kolegjit të Gjykatës, ndërsa në përmbajtje parashtrohet i njëjti kërkim me atë të paraqitur më herët në kërkesën e datës 17.03.2023, konkretisht shfuqizimi i shprehjes “*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin, sipas bindjes së tij të brendshme*” në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr. 96/2016. Në ndryshim nga kërkesa e parë, kërkuesi në kërkesën e datës 25.05.2023, ka parashtruar se dispozita ligjore e kundërshtuar është zbatuar në tri procese gjyqësore të tij, duke i

cenuar të drejtat themelore, gjë e cila justifikon edhe interesin për shfuqizimin e normës ligjore. Po kështu, sipas tij, ky kërkim është edhe i individëve të tjerë të cilët kanë probleme me drejtësinë dhe gjyqësorin në Shqipëri.

6. Kolegji thekson se çdo individ, përfshi personin juridik, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Rregullat e detajuara të procedurës së gjykimit kushtetues janë përcaktuar në ligjin nr. 8577/2000 dhe Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*rregullorja*), të miratuar me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Konkretisht, në nenin 31 të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se çdo ankim individual kushtetues i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Ndërsa në nenin 43 të rregullores përcaktohet se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në të.

7. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se, nga njëra anë, kërkuesi nuk ka kërkuar saktësimin, plotësimin ose ndreqjen e ndonjë gabimi të mundshëm në shkrim, apo ndonjë pasaktësi të dukshme në vendimin e kundërshtuar. Nga ana tjetër, argumenti i parashtruar në kërkesën e datës 25.05.2023, se dispozita ligjore e kundërshtuar është zbatuar në tri procese gjyqësore të tij, do të duhet të ishte paraqitur në kohën e shqyrtimit paraprak të kërkesës së datës 17.03.2023, pasi në rastin e ankimeve kushtetuese individuale, gjykimi kushtetues vihet në lëvizje nga vetë individi, që do të thotë se ai prezumohet se është në dijeni të kriterëve paraprake dhe jurisprudencës së Gjykatës mbi to dhe ka barrën e paraqitjes së argumenteve dhe akteve provuese që mbështesin pretendimet e tij. Megjithatë, edhe në rastin e kërkesës së datës 25.05.2023, sërish ky argument mbetet i paqartë dhe i pakonkretizuar se cilat janë rrethanat që gjyqtarët dhe prokurori, të cituar në kërkesën e datës 25.05.2023, për shkak të dispozitës ligjore të kundërshtuar, kanë disponuar me vendime që kanë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit, në kushtet kur ai nuk kërkon shfuqizimin e ndonjë vendimi gjyqësor.

8. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk gjendet në ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenin 43 të rregullores dhe, për rrjedhojë, kërkesa e tij është e papranueshme.

9. Për sa i takon argumentit të kërkuesit se kërkimi i tij është edhe i individëve të tjerë, Kolegji sjell në vëmendje se normat kushtetuese dhe ligjore, të cilat parashikojnë ushtrimin e ankimit kushtetues individual, garantojnë të drejtën e individit për të paraqitur kërkesë vetëm për

çështje që lidhen drejtpërdrejt me interesat e tij. Me fjalë të tjera, Kushtetuta nuk parashikon të drejtën e paraqitjes së një *actio popularis* për mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave të tjerëve.

10. Në përfundim, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore të analizuara më lart, në raport me rrethanat dhe faktet e rastit në shqyrtim, Kolegji çmon se kërkesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Elmaz Ahmetaj për kundërshtimin e vendimit nr. 81, datë 19.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.